



Prishtinë, 20 shkurt 2015
Kodi i ZRRE-së: V_708_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, dhe Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 24, paragrafi 6 të Ligjit për Energjinë elektrike (Ligji Nr. 03/L-201);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 05.02.2015 për shqyrtim dhe aprovim të dokumenteve: Procedurat e Rregullave të Tregut,

në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHEN Procedurat e Rregullave të Tregut:

- *Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Arovimin dhe Vlerësimin e Matjeve;*
- *Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve;*
- *Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur; dhe*
- *Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.*

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05.02.2015 ka pranuar kërkesën për aprovim të versionit final të dokumenteve **Procedurat e Rregullave të Tregut** të KOSTT SH.A. Dokumentet janë punuar në bazë të Rregullave të Tregut, dhe konsiderohen si pjesë e Rregullave të Tregut.

KOSTT ka bërë dërguar dokumentet për shqyrtim fillimisht me 20 qershor 2014. Në ndërkohë ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar por edhe drejtpërdrejt në takimet e mbajtura me përfaqësues të KOSTT nga ku janë përfshirë komentet apo janë sqaruar çështjet e ngritura, dhe përfundimisht dokumentet kanë marrë formën e duhur për aprovim.

Kështu me datë 05.02.2015 KOSTT ka dorëzuar versionin final për aprovim në ZRRE të dokumenteve si:

- Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Arovimin dhe Vlerësimin e Matjeve;
- Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve;

Procedurat e Rregullave të tregut

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



- Procedura e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur; dhe
- Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar.

Si pjesë e Rregullave të Tregut këto procedura janë të një rëndësisë së posaçme dhe bëjnë kompletimin e Rregullave të tregut dhe lehtësojnë implementimin e tyre. Ndaj ZRRE i ka analizuar procedurat e përmendura me kujdes dhe konsideron se si dokumente i përmbushin kriteret për aprovim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke aprovuar **Procedurat e Rregullave të Tregut**.


II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.


III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti Rregullat e Tregut.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar